Funded by the European Union

“SMS Facility” – Mbështetje për mediet e vogla në Ballkanin Perëndimor



Duration: 08.11.2024 - 07.11.2027

Countries:

Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Serbia, Shqipëria

EU contribution: € 1 300 000

Total budget: € 1 444 444

Implementer:

Centar za promociju civilnog društva CPCD (BiH), Thomson Media gGmbH (Germany), Science & Innovation for Development SCIDEV (Albania), Kosovo Glocal (Kosovo), Centar za demokratsku tranziciju CDT (MNE), Metamorphosis Foundation (NMK)

Project description:

Projekti “‘SMS Facility’ – Mbështetje për mediet e vogla në Ballkanin Perëndimor” suporton mediet e pavarur në Ballkanin Perëndimor dhe ndihmon në përforcimin e lirisë së medieve, diversitetit dhe demokracisë në të gjithë rajonin. Fokusohet në zhvillimin e aftësive të gazetarëve dhe medieve dhe i nxit ata të punojnë së bashku përmes platformës “Journalift”, duke u siguruar që përpjekjet të jenë të harmonizuara dhe të mos i mbivendosen njëra-tjetrës. Mediet lokale shpesh përballen me burime të kufizuara, presion politik dhe pasiguri financiare, ndaj ky projekt fokusohet në adresimin e këtyre çështjeve. Përmes këtij projekti promovohet inovacioni, menaxhimi e mirë dhe partneriteti publik-privat për të krijuar mjedis mediatik më të fortë dhe më të qëndrueshëm.
Duke përdorur MOVAT-in, projekti ndjek evolucionin e sektorit të medias dhe ofron mbështetje të përshtatur sipas nevojave të medieve. Barazia gjinore është një pjesë thelbësore e të gjitha aktiviteteve.
Përfituesit kryesorë janë mediet e vogla lokale, gazetarët (veçanërisht gazetaret dhe të rinjtë), rrjetet mediatike dhe institucionet publike, të gjithë që punojnë për të pasur komunitete më të informuara dhe praktika më të forta demokratike.
Një pjesë e veçantë e projektit, “SMS Facility”, ofron financim, trajnim dhe avokim për rreth 120 medie. Ai përfshin dy lloje grantesh: një për të mbështetur prodhimin e përmbajtjes me cilësi të lartë dhe një tjetër për të ndihmuar në përmirësimin e kapacitetit teknik dhe organizativ.

Expected results:

• Hedhja në përdorim e një platforme shumëgjuhëshe qendrore online, e cila do të shërbejë si pikë referimi për mbështetje dhe burime.
• Gjashtëdhjetë media do të marrin grante të vogla për krijimin e përmbajtjeve cilësore
• Dhjetë media do të marrin mbështetje shtesë për të përmirësuar pajisjet e tyre dhe/ose metodat e punës.
• Me mbështetjen e projektit, pjesëmarrësit në projektin “SMS Facility” do të publikojnë më shumë se 600 përmbajtje mediatike.
• Më shumë se 250 gazetarë do të përmirësojnë aftësitë e tyre për raportim më profesional dhe frutdhënës.